



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Prishtinë, 1.10.2021

Në bazë të Rregullores MF- Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, **Divizioni i arsimit gjithëpërfshirës** *nxjerr këtë:*

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin dhe promovojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psikosociale.

1. **Divizioni i arsimit gjithëpërfshirës**, u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar në ndonjërin nga fushat e ndërlidhura me përkrahjen dhe promovimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psikosociale të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin e këtyre nxënësve.

2. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për fushat prioritare në vijim:

1. *Qasje profesionale në edukim gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara*
2. *Ngritja e kapaciteteve për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve/nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.*

3. *Krijimi i ambienteve të sigurta dhe mike në shkolla, ku fëmijët ndihen të mbështetur për t'u përballur me problemet e ndryshme sociale dhe pasojave nga COVID-19;*
4. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë në një ose dy projekte që kontribuojnë në përkrahjen e nxënësve për tre kategoritë e lartëcekura.

Objektivi 1:

- ✓ Lehtësimi i përfshirjes për të gjithë fëmijët veçanërisht aftësia e kufizuar;
- ✓ Trajnime për edukatore për identifikim dhe bashkëpunim profesional për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ✓ Trajnimi i prindërve për edukim gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme me aftësi të kufizuara;
- ✓ Aktivitete në fëmijërinë e hershme, me programin për fushat e aktiviteteve për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta, me qëllim të zhvillimit të aftësive në komunikim, aftësive motorike, aftësive njohëse, të fushës socio-emocionale dhe të jetës së përditshme;
- ✓ Hartimi i materialeve për fëmijërinë hershme, dedikuar prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të rënda dhe të shumëfishta.

Objektivi 2:

- ✓ Trajnimin e mësimitdhënësve, trajenrëve, psikologëve dhe profesionistëve të tjerë për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti;
- ✓ Aktivitete specifike mësimore dhe jashtëmësimore me fëmijë/ nxënës me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Hartimi i materialeve vetëdijësuese për identifikimin e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Ngritja e kapaciteteve të DKA-ve për identifikimin e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti

Objektivi 3:

- ✓ Seanca apo trajnime me mësimdhënës për mënyrën e trajtimit të fëmijëve pa ose me përkrahje të ulët sociale viktime të dhunës, abuzimit apo të pasojave nga covid 19;
- ✓ Aktivitete psiko-sociale me nxënës dhe mësimdhënës;
- ✓ Punëtori sensibilizuese me mësimdhënës, prindër dhe komunitet për aspektet e mbrojtjes së fëmijëve, sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijës;
- ✓ Zhvillim të materialeve vetëdijësuese për fëmijë dhe prindër mbi parandalimin e të gjitha formave të dhunës e abuzimit në kontekst të shkollës dhe familjes
- ✓ Ngritje të kapaciteteve të drejtorëve të shkollave dhe DKA-ve për raportim dhe referem të dhunës sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 200,000.00 €.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 10.000 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 50.000 €.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 21 tetor 2021.

6. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është 6- 8 muaj duke filluar nga muaji dhjetor 2021.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku *një (1) vit* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikuesit, janë në dispozicion në faqen e internetit *të MASHTI*.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Rruga "Agim Ramadani", nr. 10000, Prishtinë.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën; besmira.thaqi@rks-gov.net